



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

KURRIKULA BËRTHAMË

Lënda: Ekonomi

Shkalla: VI

Klasa: XII

Tiranë 2017



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT:

1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”

2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT “EKONOMIA”

2.1.Qëllimet e programit të ekonomisë

2.2.Lidhja e kompetencave të lëndës me kompetencat e tjera kyçe

2.3.Lidhja e lëndës së ekonomisë me temat ndërkurrikulare

2.4.Lidhjet e lëndës së ekonomisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit

2.5.Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

2.6.Koha mësimore për tematikë, për secilën klasë

3. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE PËR SHKALLËN VI

4. UDHËZIME METODOLOGJIKE

5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

6. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE

1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësi: të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballet në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësi:

- kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillon përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohet për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillon shpirtin e sipërmarrjes;
- përdor teknologjitë e reja.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” i krijon nxënësit mundësitë të zhvillojë kompetencat e nevojshme për të përmbushur rolin e tij si anëtar i një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur. Kompleksiteti i botës shoqërore sot po rritet, për shkak se shoqëritë janë në një proces të vazhdueshëm ndryshimi dhe lidhjesh globale, shoqëruar me rritje të lartë të lëvizshmërisë së popullsisë, shumëfishim të kontakteve midis kulturave të ndryshme, qarkullim të shpejtë të informacionit dhe rritje të globalizimit të ekonomisë. Lëndët që përbëjnë fushën shoqëria dhe mjedisi zhvillojnë te nxënësi të menduarin kritik e krijues, pasurojnë kulturën e tyre dhe i përgatisin të luajnë një rol aktiv në një shoqëri

demokratike. Ato nxisin zhvillimin intelektual të nxënësit, duke i dhënë mekanizmat konceptualë dhe metodologjikë, të cilët nxënësi mund t'i përdorë në situata të ndryshme, e ndihmojnë të prezantojë botën dhe të përballojë situata të ndryshme në jetën e tij.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve qytetari, sociologji, ekonomi, filozofi, psikologji, histori, gjeografi. Secila prej tyre e trajton botën dhe shoqërinë nga këndvështrime të ndryshme. Përmes kësaj fushe, nxënësi zhvillon bazat e qytetarisë, duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to; zhvillon konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe zbaton këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri, në të kaluarën dhe sot; zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe rajoneve në botë. Nxënësi aftësohet të vlerësojë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin, për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm.

Programet e lëndëve qytetari, sociologji, ekonomi, filozofi, psikologji, histori dhe gjeografi janë ngushtësisht të lidhura nga kompetencat që ato synojnë të zhvillojnë te nxënësi. Përvojat mësimore të kësaj fushe të nxëni, në këtë shkallë i shërbejnë përmbushjes së kompetencave kyçe, me fokus të veçantë kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor.

2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT

Kuptimi i bazave të ekonomisë është i domosdoshëm për të interpretuar ngjarjet ekonomike dhe ndryshimet në ekonominë kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërkohë, individët dhe komunitetet përpiqen të përshtasin ndryshimet strukturore në shoqëri, të cilat burojnë nga ndikimet e ndryshimeve teknologjike dhe konkurrenca e bashkëpunimi ndërkombëtar.

Për këtë arsye, është e rëndësishme që nxënësit, hap pas hapi, të aftësohen për të marrë vendime për jetën e tyre, të jenë pjesëmarrës aktivë në një ekonomi lokale dhe globale, anëtarë produktivë të forcës së punës dhe qytetarë të përgjegjshëm, si edhe promotorë të sistemit të sipërmarrjes së lirë.

Mendimi ekonomik ose **“mënyra ekonomike e të menduarit”** është rrjedhojë e studimit të lëndës së ekonomisë. Zhvillimi i mendimit kritik i përgatit nxënësit të analizojnë dhe të vlerësojnë, jo vetëm pasojat afatshkurtra të vendimmarrjeve të tyre, por edhe rrjedhojat e pasojave afatgjata që ato sjellin.

Lënda e ekonomisë u ofron nxënësve edhe një kuadër jetësimi, brenda të cilit ata mund të analizojnë çështje dhe politika publike aktuale, të kuptojnë marrëdhëniet komplekse midis sistemeve kulturore, politike dhe ekonomike dhe të marrin vendime ekonomike personale.

Përvetësimi i parimeve të përgjithshme të mendimit ekonomik synon zhvillimin e njohurive, shprehive, qëndrimeve e vlerave që janë në përshtatje me kërkesat e kornizës kurrikulare kombëtare. Përvetësimi i njohurive ekonomike bëhet në mënyrë graduale nëpërmjet procesit të krijimit të aftësive të nevojshme të nxënësve, ndërgjegjësimit për rolin e tyre si agjentë ekonomikë, si politikëbërës dhe vendimmarrës aktivë të çështjeve ekonomike.

Realizimi i përmbajtjes së lëndës, konkretizohet me shembuj, ilustrime nga realiteti ekonomik kombëtar dhe global, përmes ushtrimit praktik të nxënësve në rolin e tyre si prodhues, si shitës të produkteve, si taksapagues, si zotërues burimesh materiale, si votues, si konsumatorë, si kursimtarë dhe si investitorë.

Nëpërmjet përdorimit të metodave didaktike në këtë lëndë, nxënësit aftësohen për të punuar në grup, për të ndërmarrë veprimtari nxitëse, fokusohen në situata konkrete, trajtojnë koncepte, fakte dhe situata ekonomike, bëjnë analiza dhe arrijnë në përfundime konkrete.

2.1 Qëllimet programit të ekonomisë

Lënda e ekonomisë synon që nxënësit:

-) të bëjnë zgjedhjet ekonomike, që përfshijnë kostot oportune dhe të marrin vendime të rëndësishme për jetën e tyre; duke përdorur arsyetimin ekonomik dhe konceptin e burimeve të kufizuara,
-) të aftësohen të fitojnë një kuptim më të mirë se si sistemet ekonomike funksionojnë duke kuptuar mekanizmat nxitëse të sistemeve të ndryshme ekonomike;
-) të ndërgjegjësohen se ne të gjithë jemi pjesë e një ekonomie botërore dhe kjo kërkon që ata të shqyrtojnë bashkëveprimin dhe ndërvarësinë në marrëdhëniet ekonomike, që rezultojnë nga këmbimi dhe tregtia.
-) të zhvillojnë aftësitë e tyre për të interpretuar problematikën ekonomike në situata të reja të zhvillimit ekonomiko-shoqëror, të zhvillojnë përkushtimin e vazhdueshëm në trajtimin e çështjeve ekonomike dhe të pjesëmarrjes aktive në zhvillimin e qytetarisë, si edhe të zhvillojnë mendimin kritik dhe aftësinë për të ndjekur problematikën ekonomike në perspektiva të reja të zhvillimit shoqëror.


Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi nxënësi të jetë i aftë:

-) të shpjegojë se si problemet ekonomike bazë, përbëjnë një sistem ekonomik, nëpërmjet të cilit u jepet zgjidhje problemeve dhe çështjeve të burimeve ekonomike, shpërndarjes së të ardhurave, stabilitetit dhe rritjes ekonomike;

- J të klasifikojë sistemet ekonomike mbi bazën e zgjidhjes që shoqëria u jep çështjeve ekonomike bazë;
- J të shpjegojë natyrën dhe veprimtarinë e sistemeve të ndryshme ekonomike;
- J të identifikojë natyrën dhe tipat e sistemeve ekonomike bazuar në konceptet e nxitjes ekonomike, ndërhyrjes dhe rregullimeve të qeverisë në politikën e tregut;
- J të shpjegojë ndërveprimin e forcave të tregut në përcaktimin e çmimeve të mallrave dhe faktorëve të prodhimit;
- J të trajtojë marrëdhëniet ndërmjet kushteve ekonomike dhe politikave të qeverisë;
- J të identifikojë faktorët që çojnë në stabilitet apo destabilitet ekonomik;
- J të shpjegojë marrëdhëniet ndërmjet qeverisë, punës, dhe konkurrencës në sistemin e sipërmarrjes së lirë;
- J të shpjegojë: rolin e financimit dhe investimit në suksesin apo dështimin e një biznesi, organizimin e bizneseve, strukturën e tregut dhe institucionet financiare që operojnë në një ekonomi tregu, marrëdhëniet ndërmjet papunësisë, inflacionit, politikave monetare dhe fiskale dhe efektet e tyre në ekonomi;
- J të interpretojë se si burimet dhe të ardhurat ekonomike shpërndahen përmes mekanizmit të çmimeve dhe politikave të qeverisjes;
- J të përvetësojë konceptet ekonomike bazë që shërbejnë për të matur performancën ekonomike dhe për të shpjeguar fenomenet ekonomike dhe si funksionon jeta ekonomike dhe përse mendimi ekonomik është i rëndësishëm për çdo individ;
- J të shpjegojë se shkëmbimi i mallrave dhe shërbimeve nxit ndërvarësinë dhe zhvillimin ekonomik midis vendeve;
- J të zotërojë terminologjinë bazë që përdorin ekonomistët, të demonstrojë mendimin kritik dhe aftësinë vendimmarrëse.

Diagrami 1: Korniza konceptuale e programit



2.2 Lidhja e kompetencave të fushës /lëndës me kompetencat e tjera kyçe

Kompetenca qytetare

Programi i sociologjisë, si pjesë e fushës shoqëria dhe mjedisi, përmes kërkimit, krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare.

Ky program kontribuon edhe në zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe. Rezultatet e të nxënit të synuara nga programi i lëndës së ekonomisë nxisin, në shkallë të ndryshme edhe zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe.

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit

Programi i ekonomisë krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale, për të eksploruar dukuritë, proceset shoqërore, politike, ekonomike, kulturore etj. në kohë dhe në hapësirë. Ai mëson si t'i vlerësojë këto burime dhe të kuptojë si gjuha mund të përdoret për të zhvilluar më tej të nxënit. Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj., nxënësi zhvillon shkathtësitë e të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audiencë të ndryshme.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe peshon argumentet. Ai zhvillon shkathtësitë për marrjen e vendimeve dhe strategjitë që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues dhe të zhvillojë imagjinatën në vëzhgimet që bën në terren.

Programi i ekonomisë nxit përdorimin e matematikës dhe të mendimit matematik, për interpretimin e të dhënave etj.

Kompetenca e të nxënit

Për të mbështetur formimin ekonomik, nxënësi shfrytëzon informacionin nga burime të ndryshme, gjykon vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij. Në procesin e kërkimit, ai përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për përgatitjen e prezantimeve të tij dhe komunikimin e gjetjeve.

Nxënësi mendon në mënyrë kritike kur shqyrton pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar, kur vlerëson zgjidhjet e problemeve globale, kur krijon dhe mbron qëndrimin e tij.

Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme ekonomike e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe. Përdor gjuhën e politikës, të ligjit, të moralit, të ekonomisë për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij dhe për të organizuar përgjigjet.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësit zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin ekonomik, ligjor, kulturor etj., me kompleksitetin e dukurive të tij, vlerëson rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme ekonomike e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë ndërsa përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim.

Kompetenca personale

Programi i ekonomisë nxit të nxënit e bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësit kuptojnë rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

Kompetenca digjitale

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur kërkon, krijon, përpunon, komunikon idetë dhe informacionin për dukuritë shoqërore, politike, kulturore etj.

2.3 Lidhja e lëndës së ekonomisë me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin, të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i lëndës së ekonomisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, si:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.
- Zhvillimi i qëndrueshëm.
- Mjedisi.
- Ndërvarësia.
- Bashkëjetesa paqësore.

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë në këndvështrimin e ekonomisë, nxënësi ndërgjegjësohet edhe për aspektet shoqërore të konsumit, për pasojat e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvarësinë e ndërsjellë të mjedisit dhe të veprimtarisë ekonomike e njerëzore.

Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes. Në këtë mënyrë ai jo vetëm kupton domethënien e veprimeve njerëzore në një vend të caktuar, por zgjedh qëndrimin e tij për çështjet globale. Programi kontribuon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvarësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

2.4 Lidhjet e lëndës së ekonomisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit

Ekonomia	Gjeografia
	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">▪ merr parasysh veçoritë gjeografike në shqyrtimin e politikave ekonomike▪ merr parasysh veçoritë dhe kushtet gjeografike në vendimarrjet ekonomike
Ekonomia	Historia
	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">▪ shqyrton dhe shpjegon politikat ekonomike në kohë dhe hapësirë.▪ merr parasysh veçoritë historike e shoqërore në hartimin e politikave ekonomike.
Ekonomia	Qytetaria
	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">▪ lidh vendimarrjet ekonomike me legjislacionin.▪ argumenton rëndësinë e faktorit “ligj” në suksesin ose dështimin e zbatimit të politikave ekonomike.

2.5 Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

Tematikat mbi të cilat është organizuar përmbajtja e programit të lëndës së ekonomisë kanë të bëjnë me njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, nëpërmjet të cilave, do të realizohen këto kompetenca. Shkathtësitë dhe qëndrimet, ashtu sikurse njohuritë, janë objekt i të nxënit të rregullt

dhe progresiv. Aftësitë u lejojnë nxënësve, nën udhëheqjen e mësuesit ose në mënyrë të pavarur, të ndërtojnë, të përvetësojnë, të reflektojnë të mobilizojnë njohuritë dhe aftësitë për të marrë vendime. Këto tematika janë:

1. Çfarë studion ekonomia
2. Kërkesa, oferta dhe çmimi i tregut
3. Konsumatori në ekonominë e tregut
4. Fillimi i nje biznesi dhe financimi i tij
5. Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës
6. Struktura e tregut
7. Tregjet e faktorëve të prodhimit
8. Qeveria dhe ekonomia
9. Paraja dhe institucionet financiare
10. Treguesit kryesorë makroekonomikë
11. Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike
12. Tregtia ndërkombëtare
13. Etika e biznesit
14. Aftësitë për sukses
15. Financat personale
16. Bëhu sipërmarrës

2.6 Koha mësimore për tematikë

Programi i lëndës së ekonomisë zhvillohet në 102 orë mësimore në vit. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat ose projektet, vëzhgimet në natyrë, testimet e ndryshme. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

3. Tabela. Orët përkatëse mësimore të tematikave për klasën përgatitore

Tematika	Orë të sugjeruara:
PJESA I: EKONOMIA E TREGUT	
1. Çfarë studion ekonomia	6 orë
2. Kërkesa, oferta dhe çmimi i tregut	9 orë
3. Konsumatori në ekonominë e tregut	3 orë
4. Fillimi i nje biznesi dhe financimi i tij	7 orë
5. Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës	5 orë
6. Struktura e tregut	6 orë
7. Tregjet e faktorëve të prodhimit	5 orë
PJESA 2: EKONOMIA KOMBËTARE	
8. Qeveria dhe ekonomia	7 orë
9. Paraja dhe institucionet financiare	4 orë
10. Treguesit kryesore makroekonomikë	8 orë
11. Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike	3 orë
PJESA 2: EKONOMIA GLOBALE	

12. Tregtia ndërkombëtare	5 orë
PJESA 4. EKONOMIA NË PRAKTIKË	
13. Etika e biznesit	9 orë
14. Aftësia për sukses	9 orë
15. Financat personale	7 orë
16. Bëhu sipërmarrës	9 orë
Totali	102 orë

3. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE

Në programin e ekonomisë janë paraqitur rezultatet e të nxënimit sipas tematikave. Rezultatet e të nxënimit shprehen në terma njohurish, aftësish dhe qëndrimesh. **Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në situata të nxënimit, kapituj ose grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë autorët e teksteve dhe mësuesit).** Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është *relativisht* rekomanduese.

PJESA 1 EKONOMIA E TREGUT

Kjo pjesë fokusohet në krijimin tek nxënësi/ja e koncepteve dhe arsytimit ekonomike mbi vendimmarrjen në kushtet e burimeve të kufizuara ekonomike. Nëpërmjet kuptimit dhe analizës së këtij fakti, krijohet një kuptim i qartë ekonomik mbi idenë se të gjitha zgjedhjet ekonomike shoqërohen me një kosto.

Nxënësit njihen me veprimin e ligjit të kërkesës dhe ofertës në ekonominë e tregut dhe pajisen me mjetet e analizës që ata mund t'i përdorin edhe në linjat e tjera. Gjithashtu ata njihen e diskutojnë për parimet mbi të cilat bazohet vendimmarrja e firmave, financimi i tyre si dhe nivelet e konkurrencës së tregut. Ç'është ekonomia dhe faktorët e prodhimit, problemi ekonomik themelor dhe sistemet ekonomike, shtyllat e sipërmarrjes së lirë, skema e qarkullimit të aktivitetit ekonomik, kërkesa, oferta, ekuilibri i tregut, kontrolli i çmimeve nga forcat jo të tregut, konsumatori, burimet e të ardhurave dhe kursimi, buxheti vetjak, planifikimi i tij, sipërmarrësi, biznesi i vogël dhe roli ekonomik i tij, format e organizimit të biznesit, burimet financiar të biznesit, tregu i letrave me vlerë, kontabiliteti i biznesit, prodhimi, kostoja, të ardhurat e firmës, konkurrenca e plotë, konkurrenca monopoliste, monopoli, oligopoli, tregu i punës, aspekte të tjera të tregut të punës, tregu i kapitalit dhe i tokës janë tematika të mundshme për t'u trajtuar në këtë linjë.

Tematika 1: Çfarë studion ekonomia		
Rezultatet e pritshme të të mësuarit		
Çfarë studion ekonomia		
Orë të sugjeruara: 6 orë		
Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime
<ul style="list-style-type: none">) Pamjaftueshmëria, zgjedhja dhe kostoja oportune) Burimet dhe kufiri i mundësive të prodhimit) Problemi ekonomik themelor. Rëndësia e ekonomisë si shkencë) Problemi ekonomik themelor dhe sistemet ekonomike) Shtyllat e sipërmarrjes së lirë 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none">) shpjegon konceptet pamjaftueshmëri, sistem ekonomik, kosto oportune dhe lidhjen shkakësore ndërmjet pamjaftueshmërisë dhe nevojës për të zgjedhur, duke pranuar koston oportune.) jep shembuj personal lidhur me marrjen e vendimeve dhe koston oportune të saj;) identifikon faktorët e prodhimit për një të mirë ose shërbim;) interpreton një lakore të mundësive të prodhimit si dhe nëpërmjet saj ilustron koston oportune”;) vlerëson mënyrën se si sisteme të ndryshme ekonomike e zgjidhin problemin ekonomik themelor;) përshkruan veçoritë e shtyllave të sistemit ekonomik të iniciativës së lirë;) përshkruan rolin e fitimit në sistemin e sipërmarrjes së lirë;) analizon se si ndërmarrja e iniciativave ekonomike nxit përdorimin e burimeve natyrore, të kapitalit fizik dhe njerëzor; 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none">) jep shembuj personal lidhur me marrjen e vendimeve dhe koston oportune që shoqëron çdo vendim të marrë.

	<p>)] përshkruan fluksin e qarkullimit të aktivitetit ekonomik që lidh familjet, firmat e biznesit dhe qeveritë në ekonominë e tregut.</p>	
--	--	--

Tematika 2: Kërkesa, oferta dhe çmimi i tregut		
Rezultatet e pritshme të të mësuarit		
Kërkesa, oferta dhe çmimi i tregut		
Orë të sugjeruara: 9 orë		
Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime
<p>)] Treg</p> <p>)] Çmim,</p> <p>)] Kërkesë,</p> <p>)] Ofertë</p> <p>)] Çmim ekuilibri</p> <p>)] Ligji i kërkesës dhe ofertës;</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>)] interpreton konceptet: treg, çmim, kërkesë, ofertë;</p> <p>)] formulon ligjin e kërkesës dhe ofertës;</p> <p>)] interpreton lakoren e kërkesës dhe ofertës;</p> <p>)] shpjegon faktorët që shkaktojnë zhvendosjen e kërkesës dhe ofertës;</p> <p>)] përcakton çmimin ekuilibër të një produkti të dhënë kur janë dhënë kërkesa dhe oferta për këtë produkt nëpërmjet grafikut;</p> <p>)] bën dallimin midis një ndryshimi në sasinë e kërkuar ose të ofruar dhe një ndryshimi në kërkesë ose në ofertë;</p> <p>)] vlerëson ndikimin e ndryshimeve të elasticitetit të kërkesës në sasinë e kërkuar dhe të ndryshimeve të elasticitetit të ofertës në sasinë e ofruar.</p> <p>)] shpjegon se si ndikojnë në çmimin e tregut ndryshimet në kërkesë dhe ofertë;</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>)] shpreh qëndrimin e tij në lidhje me motivet që qëndrojnë në themel të procesit të prodhimit të mallrave dhe të shërbimeve në Shqipëri.</p>

	<ul style="list-style-type: none">) analizon ndërveprimin e ligjit të kërkesës dhe ofertës në çmimin ekuilibër;) shpjegon se si çmimet e tregut bëjnë racionimin e mallrave dhe shërbimeve dhe motivojnë njerëzit për prodhimin e tyre; 	
--	---	--

Tematika 3: Konsumatori në ekonominë e tregut

Rezultatet e pritshme të të mësuarit
Konsumatori në ekonominë e tregut
Orë të sugjeruara: 3 orë

Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime
<ul style="list-style-type: none">) Konsumator dhe kursyes) Hartim buxheti vetjak 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) përshkruan rëndësinë ekonomike të konsumatorit në ekonominë e tregut si dhe burimet e të ardhurave të individëve dhe format e tyre;) shpjegon avantazhet dhe disavantazhet e blerjes me kredi;) shpjegon arsyet pse njerëzit kursejnë;) krahason metodat e ndryshme të kursimit;) analizon faktorët që ndikojnë në masën e kursimit;) përgatit një buxhet personal. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) shpreh qëndrimin e tij në lidhje me politikat e mbrojtjes së konsumatorit në Shqipëri;) shpreh qëndrimin e tij në lidhje me mundësitë e kursimit në Shqipëri si dhe të hartimit të një buxheti personal dhe jep ide në lidhje me të.

Tematika 4: Fillimi i nje biznesi dhe financimi i tij

Rezultatet e pritshme të të mësuarit Fillimi i nje biznesi dhe financimi i tij Orë të sugjeruara: 7 orë		
Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime
<ul style="list-style-type: none"> J Firma dhe objektivat e saj. Fillimi i një biznesi J Format e organizimit të një biznesi J Firmat individuale dhe firmat me ortakë J Korporata J Burimet financiare të firmës J Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> J shpjegon se si tregu i lirë nxit sipërmarrjen; J rendit format kryesore të organizimit të biznesit; J gjykon për avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej tri formave kryesore të biznesit; J shpjegon organizimin e korporatës J gjykon për disa nga përgjegjësitë, kërkesat dhe përfitimet që lidhen me sipërmarrjen; J dallon burimet e brendshme nga burimet e jashtme të financimit të biznesit; J shpjegon qëllimet dhe format e burimeve financiare të biznesit; J dallon ndryshimin ndërmjet aksionit dhe obligacionit; J analizon një bilanc dhe një pasqyrë të rezultateve financiare të firmës. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> J gjykon për disa nga përgjegjësitë, kërkesat dhe përfitimet që lidhen me sipërmarrjen; J shpreh qëndrimin e tij në lidhje me politikat e nxitjes së sipërmarrjes në Shqipëri.

Tematika 5: Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës
<p>Rezultatet e pritshme të të mësuarit Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës Orë të sugjeruara: 5 orë</p>

Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime
<ul style="list-style-type: none">) Prodhimi dhe funksioni i prodhimit) Prodhueshmëria) Faktorët që ndikojnë në prodhueshmëri) Të ardhurat) Kategoritë e kostos 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) bën dallimin midis kostove fikse dhe atyre variabël;) llogarit koston e përgjithshme të prodhimit, koston mesatare dhe atë marxhinale;) interpreton grafikun e kostos fikse, variabël, të përgjithshme, mesatare, marxhinale;) llogarit të ardhurat e përgjithshme, të ardhurat marxhinale dhe të ardhurat mesatare;) llogarit produktin e përgjithshëm fizik, marxhinal, mesatar;) zbulon veprimin e ligjit të të ardhurave zbritëse në gjendjen e biznesit.) shpjegon funksionin e prodhimit për periudhën afatshkurtër) tregon si llogaritet prodhueshmëria dhe si ndikon ajo në standardin e jetesës.) evidenton faktorët që ndikojnë në prodhueshmëri 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) shpreh qëndrimin e tij në lidhje me prodhueshmërinë ekonomike në Shqipëri dhe ndikimin e saj në standardin e jetesës;) shpreh qëndrimin e tij në lidhje me faktorët që ndikojnë në prodhueshmëri.

Tematika 6: Struktura e tregut		
Rezultatet e pritshme të të mësuarit		
Struktura e tregut		
Orë të sugjeruar: a 6 orë		
Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime

<ul style="list-style-type: none"> J Thelbi i konkurrencës . J Struktura e tregut në konkurrencën e plotë. J Analiza ekonomike e firmës në konkurrencë të plotë dhe në afate të shkurtra J Stuktura e tregut monopol J Konkurenca monopolistike. J Oligopoli 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> J interpreton konceptet e konkurrencës dhe strukturës së tregut; J identifikon nivelin e konkurrencës së tregjeve në ekonomi; J shpjegon karakteristikat e secilës nga strukturat kryesore të tregjeve: konkurrencë e plotë, konkurrencë monopoliste, oligopol, monopol; J diskuton raportet dhe format e shkrirjes së bizneseve; J krahason strukturat e ndryshme të tregjeve; J analizon efektet ekonomike të strukturave të tregut mbi ekonominë dhe konsumatorin J argumenton se zhvillimi i konkurrencës së lirë është në favor të të gjitha subjekteve në ekonominë e tregut. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> J shpreh qëndrimin e tij në lidhje me gjendjen e konkurrencës së lirë në Shqipëri dhe ndikimin e saj në veprimtarinë e subjekteve në ekonominë e tregut.
--	---	--

Tematika 7: Tregjet e faktorëve të prodhimit		
Rezultatet e pritshme të të mësuarit Tregjet e faktorëve të prodhimit Orë të sugjeruara: 5 orë		
Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime

<ul style="list-style-type: none"> J Puna si faktor kryesor i procesit të prodhimit. J Kërkesa për punë J Oferta e punës dhe ekuilibri në tregun e punës J Toka si faktor prodhimi. J Ekuilibri në tregun e tokës J Kapitali si faktor prodhimi 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> J interpreton ofertën dhe kërkesën për faktorët e prodhimit; J interpreton ofertën për punë dhe kërkesën për punë; J shpjegon se si kërkesa dhe oferta për punë përcaktojnë çmimin e punës, çmimin e kapitalit, çmimin e tokës; J vlerëson shkallën në të cilën forcat e tregut dhe forcat jo të tregut ndikojnë në pagat. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> J shpreh qëndrimin e tij në lidhje me mënyrën si është trajtuar vlera e tokës si faktor prodhimi në Shqipëri.
---	---	---

PJESA 2: EKONOMIA KOMBËTARE

Aktivitetet ekonomike të qeverisë ndikojnë në mirëqenien tonë të përditshme. Njohja me rolin dhe funksionet që ka një qeveri në ekonominë e tregut dhe identifikimi e analiza e problemeve të ndryshme si papunësia, inflacioni, rënia ekonomike, do të ndihmojnë nxënësit që të kuptojnë më mirë realitetin makroekonomik si dhe politikat fiskale apo monetare që ndiqen për stabilitetin e ekonomisë. Në këtë linjë nxënësit mësojnë gjithashtu përmbajtjen, funksionet dhe format e parasë në një ekonomi monetare si dhe rolin e bankave tregtare dhe të Bankës Qëndrore. Roli i qeverisë në ekonomi, buxheti i qeverisë, taksat dhe llojet e tyre, deficitit buxhetor dhe borxhi kombëtar, paraja, format dhe oferta e parasë, bankat tregtare dhe roli i tyre, banka qendrore, produkti i brendshëm bruto, inflacioni, cikli i biznesit, papunësia, matja dhe format e saj, politika fiskale, politika monetare janë tematika të mundshme për t'u trajtuar në këtë linjë.

Tematika 8: Qeveria dhe ekonomia		
Rezultatet e pritshme të të mësuarit		
Qeveria dhe ekonomia		
Orë të sugjeruara: 7 orë		
Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime
<ul style="list-style-type: none">) Roli i qeverisë në ekonominë e tregut) Këndvështrimet e teorisë ekonomike për rolin e qeverisë në ekonomi 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) shpjegon funksionin e qeverisë si arbitër dhe si subjekt në ekonominë e tregut;) shpjegon pse pjesëmarrja e qeverisë në ekonomi është rritur gjatë viteve;) përshkruan disa nga të ardhurat kryesore dhe shpenzimet në buxhetin për qeverinë shqiptare; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) shpreh qëndrimin e tij në lidhje me politikat ekonomike të qeverisë;) sugjeron zgjidhje për politikat e qeverisë në lidhje me rolin e shtetit në ekonomi, taksat etj.

<ul style="list-style-type: none">) Buxheti i qeverisë) Taksat) Deficiti buxhetor dhe borxhi kombëtar 	<ul style="list-style-type: none">) shpjegon arsyet që qeveria vendos taksa dhe pse taksimi nga qeveria është i nevojshëm;) vlerëson taksat, bazuar në parimet e vendosjes së tyre.) krahason tipat e ndryshëm të taksave, duke përfshirë taksat progresive, regresive dhe proporcionale;) interpreton konceptet e deficitit buxhetor, e borxhit publik dhe lidhjen midis tyre;) analizon përparësitë dhe mangësitë e deficitit buxhetor dhe borxhit publik;) përshkruan një ose disa propozime për të ulur deficitin buxhetor. 	
---	---	--

Tematika 9: Paraja dhe institucionet financiare		
Rezultatet e pritshme të të mësuarit		
Paraja dhe institucionet financiare		
Orë të sugjeruara: 4 orë		
Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime
<ul style="list-style-type: none">) Paraja, funksionet, format e dhe oferta e parasë.) Bankat tregëtare dhe roli i tyre) Banka e Shqipërisë dhe roli i saj 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) interpreton konceptin, karakteristikat, funksionet e parasë në një ekonomi monetare;) përshkruan procesin e lindjes dhe të zhvillimit të parasë duke evidentuar format e saj;) identifikon tipat e parasë që janë në qarkullim, në vendin tonë 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) shpreh qëndrimin e tij në lidhje me politikat bankare në Shqipëri.

	<ul style="list-style-type: none">) shpjegon ofertën monetare, rolin e veçantë të bankave si pranuese depozitash dhe dhënëse huash për ekonominë si dhe domosdoshmërinë e rezervës së detyrueshme bankare;) përshkruan organizimin dhe funksionet e Bankës Qëndrore të Shqipërisë. 	
--	--	--

Tematika 10: Treguesit kryesore makroekonomikë		
Rezultatet e pritshme të të mësuarit Treguesit kryesore makroekonomikë Orë të sugjeruara: 8 orë		
Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime
<ul style="list-style-type: none">) Treguesit makroekonomikë dhe produkti i përgjithshëm) Metodatat e matjes së GDP-së) Papunësia) Inflacioni) Ciklet e biznesit 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) përcakton treguesit që përdoren për të matur gjendjen e ekonomisë;) shpjegon konceptin e GDP-së dhe se çfarë përfshihet në llogaritjen e GDP-së;) bën dallimin midis GDP-së reale dhe GDP-së nominale;) analizon kuptimin e GDP-së për frymë e shprehur në çmime aktuale dhe çmime konstante;) përshkruan metodatat e matjes së GDP-së;) jep kuptimin për inflacionin, deflacionin;) dallon inflacionin e shkaktuar nga kostoja nga inflacioni i shkaktuar nga kërkesa;) shpjegon ndikimin ekonomik të inflacionit dhe format kryesore të inflacionit; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) shpreh qëndrimin e tij në lidhje me politikën e shtetit shqiptar në lidhje me papunësinë, inflacionin etj.

	<ul style="list-style-type: none">) shpjegon fazat kryesore të ciklit të biznesit;) shpjegon konceptin e forcës punëtore;) dallon format kryesore të papunësisë. 	
--	--	--

Tematika 11: Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike		
Rezultatet e pritshme të të mësuarit Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike Orë të sugjeruara; 3 orë		
Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime
<ul style="list-style-type: none">) Stabilizimi ekonomik dhe politikat publike) Politika monetare.) Kritikta për politikën monetare dhe fiskale. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) përshkruan mjetet e politikës fiskale;) shpjegon pse politikat fiskale janë vendime për të ndryshuar shpenzimet dhe/ose taksat nga qeveria;) interpreton efektet direkte dhe indirekte të politikës fiskale në papunësinë, prodhimin dhe normat e interesit;) përshkruan instrumentet e politikës monetare;) dallon instrumentet e politikës monetare nga ato të politikës fiskale;) përshkruan ndikimet dhe kufizimet e politikës fiskale si dhe ndikimet dhe kufizimet e politikës monetare;) identifikon rrugët në të cilat politika monetare ndikon në papunësinë, prodhimin, inflacionin dhe normat e interesit. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) shpreh qëndrimin e tij për politikat ekonomike në këndvështrimin e stabilitetit ekonomik

PJESA 3: EKONOMIA GLOBALE

Vendet dhe ekonomitë e tyre po ndërveprojnë dhe ndërlidhen gjithnjë e më shumë me njëra tjetrën, duke pasur përfitime. Kuptimi mbi tregtinë e lirë, proteksionizmin si dhe kursin e këmbimit valutor do t’i ndihmojë nxënësit të kuptojnë më mirë ndërvarësinë globale ekonomike të vendeve. Tregtia ndërmjet vendeve dhe përfitimet e saj, tregtia e lirë dhe politika proteksioniste, kursi i këmbimit valutor dhe bilanci i pagesave janë tematika të mundshme për t’u trajtuar në këtë linjë.

Tematika 12: Tregtia ndërkombëtare		
Rezultatet e pritshme të të mësuarit		
Tregëtia ndërkombëtare		
Orë të sugjeruara: 5 orë		
Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime
<ul style="list-style-type: none">) Shkaqet e tregtisë ndërmjet vendeve) Përparësitë absolute dhe përparësitë krahasuese) Tregtia e lirë dhe proteksionizmi) Kurset e këmbimit valutor dhe tregtia 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) shpjegon konceptet e përparësisë absolute dhe krahasuese;) argumenton përfitimet që kanë vendet e industrializuara kur këmbajnë midis tyre;) analizon përmbajtjen e tregtisë së lirë dhe përfitimet ekonomike të saj;) përshkruan disa pengesa në tregtinë ndërkombëtare;) jep në mënyrë të përmblodhur, argumentet që favorizojnë tregtinë e lirë;) përshkruan pse luhaten kurset e këmbimit valutor;) bën dallimin midis bilancit të pagesave dhe bilancit 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) jep në mënyrë të përmblodhur, argumentet që favorizojnë tregtinë e lirë;

PJESA 4. EKONOMIA NË PRAKTIKË

Tematika 13: Etika e biznesit

Nëpërmjet aktiviteteve të drejtpërdrejta në klasë, *Etika e biznesit* nxit vendimmarrjen etike të nxënësve, ndërkohë që ata përgatiten për t'iu bashkuar fuqisë punonëtoe dhe për të marrë pjesë në tregun global.

Rezultatet e pritshme të të mësuarit

Etika e biznesit

9 orë

Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime
<ul style="list-style-type: none">) Etika) Etika personale - Vlerat, objektivat dhe zgjedhjet) Dilemat etike - Si të vendosni?) Etika e punës - Vendimmarrja etike) Etika organizative) Përgjegjësia sociale) Etika e biznesit global - Çështjet shumëkombëshe 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) zotëron, analizon dhe përdor terminologjinë themelore, teoritë dhe konceptet që janë të zakonshme në studimin e etikës;) analizon vlerat dhe filozofinë e tij etike;) vendos përparësi etike;) përshkruan çështjet etike kryesore brenda vendit të punës dhe të botës përreth;) zbaton vendimmarrjen etike në raste dilemash;) vlerëson procesin e tij të vendimmarrjes. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) vendos përparësi etike) zbaton vendimmarrjen etike në raste dilemash.

Tematika 14 : Aftësi për sukses

Programi “Aftësi për sukses” plotëson nevojat e një grupi të ndryshëm nxënësish të shkollës së mesme për t’u ofruar atyre seanca të pasura të nxënësve praktik lidhur me gatishmërinë për punë dhe perspektivat e karrierës.

Rezultatet e pritshme të të mësuarit

Aftësi për sukses

9 orë		
Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime
<ul style="list-style-type: none">) Aftësi) Interes) Zgjedhjet) Komunikimi) Vlerat) Ndërtimi i raportit) Karriera) Komunikimi) Zgjedhje) Sinergji) Zgjidhje konflikti) Zgjedhje problemi) Reflektim) Vlerësimi) Zgjedhje karriere) Marketing) CV) Intervistë pune 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) identifikon dhe demonstroi aftësi të gatishmërisë në punë, të nevojshme për të kërkuar, për të gjetur dhe për të mbajtur një vend pune;) hulumton lidhjet ndërmjet vlerësimit personal dhe dëshirave, vlerave, objektivave dhe aftësive të tij;) zhvillon strategji të reja personale për të arritur objektivat e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe për mundësi për karrierë;) identifikon dhe zbaton strategji të nevojshme për zgjidhje efektive të problemeve në kontekstin e jetës reale;) eksploron dhe përdor strategji të komunikimit efektiv formal dhe informal. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) vlerëson strategjitë për të punuar në mënyrë të efektshme me të tjerët për të arritur një synim të përbashkët;) vlerëson dhe zbaton aftësi të të folurit dhe të dëgjuarit efektiv për zgjidhjen e konfliktit.
<p>Tematika 15: Financat personale</p> <p>Nxënësit mësojnë që planifikimi dhe menaxhimi janë shumë të rëndësishëm për të pasur financa të shëndetshme personale. Ata mësojnë të analizojnë ngjarjet, çështjet kryesore të jetës të cilat ndikojnë në financat e tyre personale. Po kështu ata njohin elementet themelore të finacave të tyre personale dhe zbatojnë njohuritë dhe aftësitë e fituara në planifikimin e finacave të tyre.</p>		
<p>Rezultatet e pritshme të të mësuarit</p> <p>Financat personale</p>		

7 orë		
Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime
<ul style="list-style-type: none">) Fitime) Kursime) Investim) Menaxhim i riskut) Buxhetim) Arsimim) Të ardhura për gjithë jetën) Financa personale 	<p>Nxënësi;</p> <ul style="list-style-type: none">) përshkruan përbërësit themelorë të financave të tij personale si: fitimi, kursimi, investimi, kredia, menaxhimi i riskut etj.;) zbaton njohuritë e tij për përbërësit themelorë të financave personale në hartimin e planit personal financiar që i mundëson vendosjen e objektivave të veçantë afatgjatë për nevojat dhe cilësinë e dëshiruar të jetës;) analizon rëndësinë e kursimit për financat personale dhe shpjegon rëndësinë e kursimeve të shëndetshme në të gjitha fazat e jetës;) vlerëson ndikimin që kanë zgjedhjet personale për arsimimin e tij në të ardhurat gjatë gjithë jetës;) identifikon risqe të mundshme për financat personale dhe disa nga rrugët për të parandaluar humbjet e mundshme. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) vlerëson ndikimin që kanë zgjedhjet personale për arsimimin e tij në të ardhurat gjatë gjithë jetës;) shpreh nevojën për të marrë vendimet e duhura për të shmangur pasojat e padëshiruara dhe me kosto të lartë.
<p>Tematika 16: Bëhu sipërmarrës!</p> <p>Duke zhvilluar përbërësit thelbësorë të një plan biznesi, nxënësit nxiten që të fillojnë një aktivitet sipërmarrjeje. Por kjo tematikë nuk del jashtë kufijve arsimorë dhe të një përvoje arsimore. Po kështu, kjo tematikë nuk synon të japë këshilla të caktura biznesi, financiare ose profesionale për nxënësit për të ndërmarrë nisma personale.</p>		

Rezultatet e pritshme të të mësuarit
Bëhu sipërmarrës!
9 orë

Njohuri të sugjeruara	Rezultatet e pritshme të të mësuarit	Qëndrime
<ul style="list-style-type: none">) Sipërmarrës) Shpirt sipërmarrës) Avantazh konkurrues) Grup demografik) Etikë) Ekskluzivitet) Marketing) Biznes jofitimprurës) Zhvillimi i produktit) Sipërmarrës social) Përgjegjësia sociale) Grupe të ndërvarura interesi 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) përshkruan karakteristikat dhe praktikat e sipërmarrjes së suksesshme;) vlerëson një ide sipërmarrëse, duke u bazuar tek produkti, klienti dhe në kriteret e avantazhit konkurrues;) demonstroi aftësitë e planifikimit të biznesit për ngritjen e një sipërmarrjeje, për marketimin, financimin, menaxhimin dhe vendimmarrjen etike;) vlerëson pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të marrjes së vendimeve etike. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">) vë në jetë pasionet, talentet dhe aftësitë e tij për një vlerësim të nevojave të tregut për të përcaktuar planin e biznesit;) pranon të qenët etik si faktor i mundshëm pozitiv për biznesin;) demonstroi rëndësinë e zgjedhjes së avantazheve konkurruese.

4. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përmbajtja e lëndës së ekonomisë ofron mundësi të shumta që mësuesit të zhvillojnë orë mësimore bazuar në :

- Z ndërveprimin aktiv midis mësuesit dhe nxënësve;
- Z shfrytëzimin e përvojave personale të nxënësve;
- Z pjesëmarrjen efektive të nxënësve në veprimtaritë mësimore;
- Z pavarësinë e nxënësve në shprehjen e lirë të ideve dhe opinioneve vetjake;
- Z përdorimin e mjeteve didaktike të domosdoshme për zhvillimin normal të programit.

Ky edukim arrihet nëpërmjet përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive ndërvepruese që krijojnë një bashkëpunim harmonik midis mësimit dhe të nxënësve, ku ndërthuren lloje të ndryshme të edukimit, të tilla si: edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe, edukimi global, edukimi nëpërmjet medias, edukimi mjedisor, edukimi rrugor, edukimi ekonomik etj.

Programi i kësaj lënde është element i një kurrikule të hapur të formimit qytetar e sociologjik dhe si e tillë ajo nuk i pranon lehtë format tradicionale të mësimit dhe të të nxënësve, kur roli i mësuesit është thjesht transmetues i dijeve, kurse fëmija një dëgjues pasiv. Të kundërtën synon ky program. Ai motivon një ndërveprim të efektshëm ndërmjet nxënësve dhe mësuesit, ndërmjet punës në grupe të vogla dhe të mëdha, ndërmjet punës së pavarur dhe asaj individuale, duke i dhënë përparësi nxitjes së ideve të ndryshme, të shumta të dalta nga nxënësit, reflektimit kritik të tyre ndaj koncepteve të përmbajtjes lëndore. Me rëndësi vlerësohen rezultatet e veprimtarive që mund të përgatiten nga nxënësit në klasë, si postera, struktura të ndryshme mendore, gazeta ose reflektime të shkruara për çështje të ndryshme. Rezultatet e nxënësve vlerësohen si tregues cilësor i zbatimit të këtij programi.

Kërkesat e kësaj lënde janë të mëdha. Ajo kërkon debat, gjallëri, mbajtje qëndrimesh, opinione të ndryshme, këndvështrime të shumëllojshme nga ana e nxënësve, gjë që lidhet me formimin gjuhësor, shkencor dhe aftësitë personale të tyre, të cilën ua mundësojnë edhe lëndë të tjera të kurrikulës së këtij cikli shkollimi. Në këtë kontekst, lënda e ekonomisë ndërthur dhe integron natyrshëm shumë njohuri të fituara në lëndë të tjera.

Një aspekt tjetër i shtjellimit të kësaj lënde është përdorimi i përvojave personale, i ngjarjeve të ndryshme të komunitetit ku ata bëjnë pjesë, si studim rasti për shumë tema mësimore dhe objektiva që synon të pëmbushë kjo lëndë.

Në këtë kuptim, “studimi i rastit” nga komuniteti shërben si ura lidhëse midis formimit të nxënësve në shkollë dhe jetës reale që përballojnë. Rezultati i kësaj mënyre të vepruarit reflektohet natyrshëm në qëndrimet që nxënësi do të mbajë konkretisht brenda grupit shoqëror, të cilit i përket.

Mësuesit përdorin dhe zhvillojnë modele të ndryshme mësimore, por ky program kërkon së pari planifikimin dhe zhvillimin e mësimdhënies ndërvepruese, që ka në themel bashkëveprimin mësues-nxënës dhe me mjedisin fizik, materialet didaktike, si dhe produkte të shumta të hartuara dhe të përgatitura nga vetë nxënësit, punën në grupe të shoqëruar me punën e pavarur dhe atë individuale.

Çfarë kërkohet nga mësuesi i lëndës së ekonomisë?

Rolet dhe kompetencat që mësuesit dhe nxënësit kanë pasur tradicionalisht, sot kanë pësuar ndryshime. Disa nga ndryshimet që kanë ndodhur në kompetencat tradicionale të mësuesve lidhen me:

) *dijet e integruara ndërlëndore përkundrejt dijeve të kufizuara në kuadrin e lëndëve të veçanta* në: lëndët mësimore, teoritë dhe çështjet që lidhen me natyrën dhe zhvillimin njerëzor, përshtatjen e teorive të ndryshme të të mësuarit për arritjen e synimeve të veçanta edukative (në fushën e sjelljes, të njohurive dhe të humanizmit), parimet e procesit të mësimdhënies/ të të nxënës, organizimin dhe administrimin e veprimtarive në grup;

-) *procesin e shumëfishtë dhe dinamik të mësimdhënies përkundrejt procesit linear dhe statik të saj*, në të gjitha përmasat e tij: a) në përpunimin dhe përcaktimin e objektivave të larmishëm; b) në administrimin elastik të orëve të mësimit dhe të grupeve; c) në shumëllojshmërinë e modeleve të mësimdhënies përmes të mësuarit të hapur dhe në bashkëpunim; d) në vlerësimin e ndërsjellë;
-) *synimet edukative të shumëfishta përkundrejt atyre të kufizuara në fushën e njohurive. Të parat marrin parasysh kompleksitetin dhe ndryshimet që ndodhin në botën e sotme dhe mbështeten në angazhimin individual për të përmirësuar kushtet e jetës dhe për të zotëruar shprehitë e nevojshme për veprim.*

Një prej kërkesave më të rëndësishme në fushën e mësimdhënies është bindja e mësuesit në aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe që ai vetë është i aftë t'i mësojë ose t'i ndihmojë për të mësuar. Të mësuarit për vendimmarrje ekonomike përfshin edhe aftësi të tjera të mësimdhënies që janë të rëndësishme për procesin e aftësimit të nxënësve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm:

-) aftësia për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tija;
-) aftësia për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve;
-) respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;
-) aftësia për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballur me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;
-) aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
-) bindja në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;

-) aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;
-) gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësim prej tyre;
-) aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuar nga kurrikula e fshehtë.

Mjedisi i të nxënit të ekonomisë

Të mësuarit e ekonomisë nxit një metodë që synon të përfshijë të gjithë shkollën, nga metodat e mësimdhënies dhe të të nxënit dhe nga pjesëmarrja e nxënësve, e stafit arsimor, e prindërve në marrjen e vendimit dhe sa më shumë të jetë e mundur në kurrikulën e arsimit formal dhe joformal.

Ai kërkon që nxënësit të njihen dhe të pranohen si subjekte të drejtash, nga njëra anë, dhe si bartës të drejtash, nga ana tjetër.

Të mësuarit e ekonomisë zgjerohet dhe mbështetet nga bashkëveprimi krijues ndërmjet institucioneve arsimore dhe të komunitetit, duke nënkuptuar edhe bashkëveprimin ndërmjet të nxënit formal dhe joformal. Si i tillë ai kërkon mbështetjen e duhur ligjore dhe financiare për zhvillime autonome në të gjitha nivelet.

Të mësuarit e ekonomisë duhet të zhvillohet duke vendosur partneritete, duke vlerësuar pozitivisht kulturat dhe mënyrën e jetesës demokratike të rinisë dhe në vetëshprehjen dhe aspiratat e nxënësve dhe të rinjve për t'u dëgjuar, duke ndërmarrë kërkime që kanë në bazë pjesëmarrjen dhe zbatimin në praktikë të nismave dhe risive në fushën e studimeve ekonomike etj., duke nxitur informacionin për përdorimin e teknologjive të

komunikimit në fushën e arsimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë vlerësimit përzgjedhës, kritereve të informacionit dhe mbështetjes së nismave e të së drejtës për të shfrytëzuar TIK-un në fushën e edukimit për ekonomi.

Nxënësit me nevoja të veçanta

Programi i lëndës së ekonomisë duhet t'u krijojë mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënëit e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motive, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. dhe të zhvillojnë mësimin në mënyrë të tillë që përputhet me stilet e të nxënëit të nxënësve, veçanërisht të atyre me nevoja të veçanta.

a) Nxënësit me vështirësi në të nxënë

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënëit njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të rezultateve të pritshme të të nxënëit, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënëit e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herëpashere me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

b) Nxënësit e talentuar

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar.

Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënit brenda dhe jashtë shkollës.

5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Vlerësimi i nxënësit shtrihet gjatë gjithë procesit mësimor dhe nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës. Vlerësimi është një proces kompleks që duhet të përmirësohet në mënyrë të pandërprerë në të gjithë treguesit e vet.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit të lëndës sociologjia dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva që nuk përshkruhen në program.

Mësuesi zhvillon mënyra vlerësimi të shumëllojshme dhe angazhon edhe nxënësit në këtë proces kompleks.

Vlerësimi bëhet për arritje individuale ose/dhe në grup, në klasë ose/dhe jashtë saj. Nëse nxënësit punojnë në grupe të vogla për objektiva të caktuara, mësuesi sqaron rëndësinë e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të çdo nxënësi në veçanti.

Nxënësi vlerësohet me notë ndërkohë që paraqet arritjet e tij me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarish e punimesh të caktuara.

Në orët e lëndës së ekonomisë nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë për përvetësimin e njohurive dhe për realizimin e detyrave të ndryshme të lëndës jashtë klase.

Mësuesi duhet të vlerësojë, duke u sqaruar nxënësve pikësynimet dhe kriteret e vlerësimit.

Vlerësimi me shkrim synon të nxisë aftësimin e nxënësve për të komunikuar me shkrim sa më saktë njohuritë ekonomike. Vlerësimi me shkrim mund të realizohet në mënyrë tradicionale, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi planifikon provime me shkrim për njohuritë e disa mësimëve ose kapitujve, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësit. Përdoren lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet për objektiva të veçantë të të nxënësit deri tek ata komplekse që zgjasin një orë mësimore dhe

që përmbajnë pyetje që testojnë saktësinë e përvetësimit të koncepteve sociologjike, pyetje që kultivojnë të menduarit kritik, krijues, eseistik etj. Gjithashtu mësuesi vlerëson edhe paraqitjen me shkrim nga nxënësit të detyrave tematike, të projekteve kurrikulare etj.

Një formë e paraqitjes me shkrim nga nxënësi është edhe provimi përfundimtar.

Një formë vlerësimi dhe vetëvlerësimi është edhe portofoli i nxënësit, çka është një përmbledhje e tij në lëndën e ekonomisë përgjatë disa muajve ose gjithë vitit shkollor. Portofoli mund të përmbajë provime me shkrim, detyra për çështje të caktuara shoqërore, projekte kurrikulare, kasete me intervista të incizuara, fotografi, filmime ngjarjesh të caktuara që ilustrojnë ide sociologjike të rëndësishme etj.

Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësi, ndërkohë që mësuesi është në rolin e këshilluesit.

Në procesin e vlerësimit, është e domosdoshme që mësuesi të marrë parasysh edhe vështirësi të veçanta të dokumentuara zyrtarisht, si vështirësitë specifike që kanë në komunikimin me gojë ose me shkrim fëmijët e emigrantëve të kthyer në atdhe pas shumë vitesh etj. Në varësi nga aftësitë e secilit zbatohen forma të veçanta kontrolli me gojë ose me shkrim.

Nxënësit që kanë jetuar për disa vite në sisteme të tjera kulturore si bij ose bija të familjeve të emigrantëve në forma të ndryshme mund të ofrojnë edhe për nxënësit e tjerë të klasës përvojën e tyre të komunikimit ndërkulturor. Përvoja të tilla të gjalla janë shembuj që përvetësohen në mënyrë të natyrshme nga nxënësit adoleshentë.

Të veçanta

Rezultatet e pritshme të studimit të lëndës “Ekonomia” përmbajnë katër elemente të lidhura me njëra-tjetrën: njohuritë, aftësitë intelektuale të reflektimit të thellë rreth çështjeve të ndryshme shoqërore, nxitjen e pjesëmarrjes në veprimtari ekonomike e shoqërore të shumëllojshme dhe

edukimin e vetëdukimit ekonomik. Të marra së bashku këto elemente përbëjnë bazën për zhvillimin e lëndës ekonomisë dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve në këtë lëndë.

I. Njohuritë qëndrojnë në qendër të sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen në pyetje të tilla si:

- Çfarë roli të veçantë luan dija ekonomike në shpjegimin e dukurive ekonomike?
- Si ndikon përparimi i ekonomisë në zhvillimin e shoqërisë?

II. Aftësitë intelektuale që kultivon lënda “Ekonomia” përfshijnë përdorimin e njohurive, të koncepteve për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese, për të realizuar studime të thjeshta për dukuri e çështje ekonomike e shoqërore, për të formuluar rekomandime për rrugëzgjdhje të problemeve të ndryshme ekonomike, që kanë të bëjnë me interesa të individit ose të grupimeve shoqërore.

III. Aftësitë pjesëmarrëse që kultivon lënda “Ekonomia” shprehen si përpjekje për t’u angazhuar në jetën publike, ekonomike e shoqërore, duke diskutuar në mjedise të gjera publike ide dhe interesa ekonomike të caktuara të grupimeve shoqërore, duke bashkëpunuar me të tjerët në veprimtari të ndryshme, duke u angazhuar në zgjidhjen e problemeve ekonomike në frymën e interesit të përbashkët etj.

Në vlerësimin e nxënësve në lëndën e ekonomisë është mirë të mbahen parasysh edhe refleksionet e tyre për vendimmarrje të ndryshme ekonomike.

Theksojmë se nuk do të vlerësohet pjesëmarrja e nxënësit, por aftësitë e tij vetjake intelektuale për të reflektuar rreth veprimtarive të tilla.

Përreth formimit teorik-intelektual lënda “Ekonomia” do të ndikojë edhe në shoqërizimin e nxënësve adoleshentë me cilësitë më të mira të veprimtarit ekonomik e shoqëror me personalitet të afirmuar, si: dinjiteti vetjak, aftësia për të gjykuar në mënyrë të pavarur rreth problemeve të ndryshme ekonomike, aftësia për t’u pozicionuar në anën e grupimeve shoqërore që ofrojnë zgjidhje më të efektshme e afatgjata, aftësia për t’u

informuar në mënyrë dinamike për zhvillimet ekonomike në vendin tonë dhe në vendet më me ndikim në shkallë botërore, aftësia për të nxjerrë përfundime teorike e praktike nga situatat globale dhe rajonale të vlefshme për vendimmarrje ekonomike etj.

Natyrisht, **nxënësi nuk do të vlerësohet për modelet e sjelljeve të tij vetjake, por për argumentimin e domosdoshmërisë së modeleve të sjelljeve të caktuara në mjedise përkatëse etj.**

6. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënës në fushën shoqëria dhe mjedisi ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj.

Ndërsa mësuesi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues, ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënës. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në ekonomi është e larmishme: biblioteka, uebsite etj. Gjithashtu burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

Sugjerime për përdorimin e TIK-ut

Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.

Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet ueb për njohuri për ekonominë.

Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit për temat që studiohen.

Organizimi dhe prezantimi i të dhënave duke përdorur tipa të ndryshëm software-sh.

Përdorimi i simulimeve software.

Përdorimi i grafikëve software.

Paraqitja grafike e të dhënave.